

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
NOTERE REZARTA B. KOÇI

Nr. 2203 Rep.

Nr. 797 Kol.



AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
SHOQERISE "AEE SERVICE" sh.p.k .

Në Tiranë, sot më 18.04.2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë), para meje noteres publike Rezarta B. Koçi, anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë, me seli në rrugën "Bulevardi Zogu i Parë", pranë "Ministrisë së Drejtësisë", Njësia Bashkiake Nr. 9, u paraqit personalisht:

THEMELUESI:

Z. Sokol Perçuke, i biri i Irakli, me datëlindje 08.04.1987, lindur në Fier dhe banues në Fier, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vpruar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit elektronik me nr. 024541082 dhe me nr personal I70408071J hartojë këtë statut të shoqërisë "AEE SERVICE" sh.p.k .mbështetur ne ligjin 9901 date 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ligjin 9723 date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, si me poshtë

NENI 1

Te krijoj shoqërinë tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar "AEE SERVICE" sh.p.k , e cila do të veproje ne përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, dispozitat e kësaj kontrate, me statutin bashkëngjitur kësaj kontrate, me ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" nr 9901 date 14.04.2008 dhe formalitetet qe duhen plotësuar ne te.

Kjo shoqëri do të emërtohet "AEE SERVICE" sh.p.k .

NENI 2

Shoqëria "AEE SERVICE" sh.p.k .. do të ketë Qendrën ne Tirane, Kashar, ruga dytesore, mbikalimi kasharit, objekti ne zonen kadastrale 2105 dhe do të ushtroje veprimtarinë e saj private për një periudhe kohore mbi 10 vjet, ne përputhje me legjislacionin ne fuqi.

NENI 3

Shoqëria do të ketë për objekt te veprimtarisë te saj:

Servis automjetelesh. Tregtim i pjeseve te kembimit te automjeteve. Tregtim i automjeteve.

NENI 4

Shoqëria mund të ndryshoje emërtimin, vendqëndrimin, selinë, kohëzgjatjen, pjesëmarrjen e kuotave, objektin e veprimtarisë se saj, me vendim te ortakut sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jete: 100 leke (njeqind Leke) e përbërë nga një kuotë e vetme dhe i perket ortakut te vetem si me poshte.

1. Sokol Perçuke

me 100 % te kuotave = (100 leke)

Çdo kuote i takon e drejta e një vote.



NENI 6

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimeve që do të marre ortakut, por në asnjë rast njeri ortak nuk mund të detyrohet ortakët e tjerë të rrisin kuotën e tyre në kapitalin e shoqërisë. Në rast se kapitali i shoqërisë për shkak të humbjeve të vërtetuara në dokumentet financiare, rezulton me i vogël se gjysma e kapitalit themeltar, ortakët vendosin brenda tre muajve nga miratimi i llogarive të përcaktojnë këtë humbje mbi mundësinë e prishjes së parakohshme të shoqërisë. Në rast se prishja nuk shpallet, shoqëria zvogëlon kapitalin e saj me një vlerë jo më të vogël se ajo e humbjeve që kanë mbetur, pa mbuluar fondet rezerve.

NENI 7

Ortakut që ka ndërmend t'u shesë të tretëve kuota të kapitalit të tij, tërësisht apo pjesërisht, duhet të njoftojë me parë ortakët e tjerë të shoqërisë, të cilët kanë të drejtën e parablerjes qofte dhe në kushte të barabarta. Kjo e drejtë duhet ushtruar brenda 30 ditëve nga data e komunikimit. Për hollësi të mëtejshme ortakët do të referohen dispozitave të parashikuara në Ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" nr 9901 date 14.04.2008.

NENI 8

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e ortakeve;
- Administratori .

Procedura për emërimin në funksionet përkatëse dhe shkarkimin e tyre rregullohen sipas statutit të shoqërisë.

NENI 9

Administrator i shoqërisë është **Z. Sokol Perçuke**, i biri i Irakli, me datëlindje 08.04.1987, lindur në Fier dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vpruar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit elektronik me nr. 024541082 dhe me nr personal I70408071J.

Administratori zgjidhet për 5 vjet kohe me të drejtë ripërtëritjeje

NENI 10

Vendimet e Asamblesë janë të vlefshme nëse janë miratuar nga ortakët e saj sipas dispozitave të Ligjit Për Shoqëritë Tregtare në lidhje me pjesëmarrjen dhe shumicën e votave sipas kuotave në kapitalin themeltar për Asamblenë e Zakonshme dhe të Jashtëzakonshme. Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Zakonshme dhe të Jashtëzakonshme, kompetencave të ortakeve dhe marrjes së vendimeve do të bazohet në statutin e shoqërisë si dhe në Ligjin "Për shoqëritë tregtare".

NENI 11

Likuiditet dhe transaksionet financiare do të depozitohen në bankat shqiptare dhe në ato të huaja, ku shoqëria ka llogarite e saj rrjedhëse.

Për kapitalin themeltar të shoqërisë është hapur libri i llogarive ku do të shënohet kontributi i ortakut të vetem. Po kështu shoqëria ka dhe përdor dokumentacionin sipas kërkesave të ligjit për kontabilitetin si dhe gjithë kërkesave të tjera financiare, të domosdoshme për veprimtarinë normale të saj.

NENI 12

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria do të ndahet ndërmjet ortakut të vetëm mbasi të jënë likuiduar të gjitha detyrimet, dhe të jetë hequr 5% që do të futet në fondin e rezervës ligjore deri në përmbushjen e 1/10 të kapitalit të shoqërisë.

NENI 18

Shoqëria fillon veprimtarinë e saj vetëm pasi të ketë marrë autorizimin e organeve kompetente sipas legjislacionit në fuqi.

Ky akt themelimi u përpilua në katër dokumente origjinale me fuqi të barabartë secila, për t'u depozituar në QK.R, Degën Rajonale Tatimore, zyrën e noterisë si dhe një kopje ruhet në dokumentacionin baze të shoqërisë.

ORTAKU I VETEM

Sokol PERÇUKE

Sokol Perçuke


NOTERE

REZARTA B. KOÇI




